



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:025349

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05352654

P.nr.1504/18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtorin profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit V. (S.) P., nga fshati Bicaj, R. Shqipërisë, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale, vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren me numër PP/II nr.4451/2012 të datës 13.12.2012, jashtë seancës gjyqësore, më datë **15.02.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren me numër PP/II nr.4451/2012 të datës 13.12.2012, dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarit V. (S.) P., nga fshati, R. Shqipërisë, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, për arsye të parashkrimit absolut (**ndalesa absolute e ndjekjes penale**).
- II.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën me PP/II nr.4451/2012 të datës 13.12.2012, dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarit V. (S.) P., nga fshati Bicaj, R. Shqipërisë, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

Gjyqtari i çështjes lëndën me numër P.nr.1504/2018 e ka pranuar më datë 12.02.2024, e cila deri në këtë datë ka qenë në menaxhim dhe udhëheqje nga një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate. Gjykata lidhur me këtë rast nuk ka arritur të caktoj ndonjë seancë gjyqësore dhe nuk ka marrë asnjë veprim proceduralo-juridik, përmes të cilit do të trajtohej çështja apo lënda penale.

Pas kontrollimit dhe shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, gjykata konstatoi se vepra penale vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, ka arritur parashkrimin absolut.

Vepra penale, vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit

të Përkohshëm Penal të Kosovës, thekson se: “ (1) Kushdo që kryen vjedhje nga neni 252(1) dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, nëse vepra është kryer në mënyrën e mëposhtme: 1) Duke thyer me forcë ndërtesat e mbyllura, dhomat, arkat ose sanduqet a hapësira të tjera të mbyllura përmes përdorimit të forcës ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme”,2) Duke vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme dhe të vrazhdë;

Nga shkresat e lëndës dhe dispozita e lartcekur ligjore, gjyqtari i vetëm gjykuese konstatoi se vepra penale, vjedhja e rëndë, nga neni 253 par.1 nënpar.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dyshohet se është kryer gjatë muajit tetor të vitit 2012 dhe për këtë veprë penale është paraparë që të shqiptohet dënimi me me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”.

Andaj, është konstatuar se për këtë veprë penale ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale bazuar në nenin 90 par. 1 nën par. 4 të Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës: prill 2004 , ku parashihet që *ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar Pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet*. Ndërsa, bazuar në nenin 91 par.6, (6) Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale). Kurse në rastin konkret nga koha e kryerjes së veprës penale nga të akuzuarit V. (S.) P., (tetor 2012) e deri në ditën e marrjes së këtij vendimi gjyqësor (15.02.2024), kanë kaluar më shumë se katër (8) vjet dhe ka arritur parashkrimi - ndalesa absolute e ndjekjes penale.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3. të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
P.nr.1504/18 më datë 15.02.2024

B. Profesionale
Afërdita Kicaj

Gjyqtari
Lulzim Hoxha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa, në afat prej 3 (tre) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.